

Ndarja e boshit

Ndoshta, duke parë tablotë e këtij piktori, secili prej nesh do të konstatojë më së pari boshin. Ose më mirë aktin e boshit. Le të jetë kështu. Po, për çfarë boshi flasim ? Me pak vonesë ne mund të shquajmë se ky bosh i këtushëm nuk punon në regjimin e fantastikes. Nëse ndonjë kusht psikologjik përcakton në subjektivin e këtij piktori vullnetin e ndonjë stili, gjendja njerëzore e tablosë do të ishte arbitrare. S'do të kishte pse të vlerësohej zënia kaq e paktë e hapësirës. Përkundrazi, ky bosh është firmosur tashmë prej një njerëzimi dhe qytetërimi të dhënë. Tabloja nuk është boshatisur prej sjelljes njerëzore. Nuk ka në tablo, as në detaj, të dhëna të ndonjë ikjeje ose braktisjeje prej njeriut. Mos gaboni të më sillni si dëshmi të së kundërtës telefonin e lënë hapur pa kujdes. Do t'i përngjiste një gjurme që do të gënjejë një hetues të pakujdesshëm. Boshi këtu i takon zhdukjes çastësore dhe të papritur, pa ndonjë qëllim.

Nëse ndjejmë ndopak fikcion, fanta-shkencë po deshët, kjo vjen nga mënyra sesi na porpozohet jashtësia. E banuar apo bosh, ajo nuk është as njerëzore, as natyrore. Brendësitë mbartin vetëm gjurmë të moshave njerëzore, lodër, foto, shtrat. Edhe po të na shfaqet një fëmijë, me qeshje në buzë, një top nën sqetull, me të gjelbrën shpirtgjerë në të majtë të vet, ne nuk mund të nxjerrim aspak përfundimin se kemi një gjendje normale. Hapja drejt jashtësisë është gjithnjë kontingjencë. Një copë jashtësie pa rëndesë. Një copë e të gjelbrës homogjene, thirrje e tepërt fluturimi. Çka vjen nga jashtë është premtimi i fluturimit.

Ndjejmë si një bosh të tretë. Së pari boshi i brendshëm, pastaj boshi i jashtëm. Në vend të tretë : boshi pa ndërmjetësim i zhdukjes, i evakuimit të papritur. Ky evakuim nuk është ai i njeriut, ose banorëve të këtyre hapësirave. Është më tepër ai i veprimit. Më vjen t'i thërrasë fëmijës, t'i japë urdhrin të mos dalë jashtë. E kotë. E di mirë. Në po atë çast kam sigurinë se ai nuk e ka fare qëllimin të dalë. Po njësoj për fëmijën në foto, me shpendin. Ai e ka gjetur njësinë e kohës. Sepse ai e dinte diçka paraprakisht, prej gjithnjë. Është shenjë e një pjekurie të parakohshme të vetë njerëzimit. Për të ditur, për të njohur, njerëzit e këtyre vendeve nuk kanë pasur nevojë për kohë. Të dy fëmijët përsërisin vështrimin kalimtar të lexuesit të gazetës mbi shpendin që sapo hyn. Qëndrim i lëshuar i njeriut tek lexon gazetën është i barabartë me vështrimin që i hedh shpendit. Edhe njëherë evakuim i veprimit.

Të boshatisësh hapësirën, për njerëzimin që ka qenë këtu, do të thotë të boshatisësh prej veprimit. Tamam sikur hapësirat të jenë vende intimiteti të detyruar. Gjumi, një gjumë i rremë, zënie e dytë e kohës pas leximit të lëshuar të gazetës. Nuk ka më të nesërme. Veç mund të na shkojë ndër mend një e shkuar, për pak. Dëshmi plastike e diçkaje që nuk do të dimë ta vendosim. Nuk është fikcion, por fiksim i kohës së piktorit. Rënia në psikologjikun e tij bëhet e afërt. Duhet t'i shpëtojmë me urgjencë. T'i ikim portretit të tij në e plastifikimit tërësor. Boshi është ngurtësimi i membranave që ndajnë tre boshët.

Ja një lloj përfundimi : boshi ishte aty. I vetmi veprim i së shkuarës që mund ta hamendësojmë, ishte vendosja e pareteve në bosh për të supozuar të plotën. Kjo gjurmë arti nuk vjen veçse nga

veprimi bosh mbi boshin. Njerëzimi që shënjohe aty nuk ka nevojë për dije. Fëmija i fotos është një shejtan që prodhon bosh me bosh. Vetëm ka vendosur ca objekte të përditshme për të na ngatërruar. Ne jemi plot dije, ne vuajeristët. Ne lexojmë kudo...

Elvis Hoxha